



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 98, datë 13.06.2018**

**PËR**

**MIRATIMIN E Z. LUAN BREGASI, Z. RAPO ÇELAJ DHE Z. ALEKSANDËR  
MUSKAJ, SI ANËTARË TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË SHOQËRISË  
“ATLANTIK - SHOQËRI SIGURIMESH” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neneve 17, 20, 21, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të Rregullores nr. 137, datë 21.12.2015 “Mbi procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administratorit/anëtarit të bordit të drejtorëve të shoqërisë së sigurimit”, e ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e z. Luan Bregasi, z. Rapo Çelaj dhe z. Aleksandër Muskaj, si anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë “Atlantik - Shoqëri sigurimesh” sh.a., me një afat 3-vjeçar, nga data 25.05.2018 deri në datë 25.05.2021.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Ervin KOÇI**